



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:208995

Datë: 30.01.2023

Numri i dokumentit: 03917187

P.nr.01/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Rrahman Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: L.B, për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.235/2019, të datës 16.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 30.01.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Njazi Rexha dhe të akuzuarit L.B, të njëjtën ditë shpalli publikisht dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.B, nga i ati A..., e ëma B..., e gjinisë H..., i lindur me data e lindjes ..., ne Mitrovicë, me vendbanim ne fshatin ... komuna e Mitrovicës, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, i papunë, i martuar, pa fëmijë, ka te kryer tetë vite te shkollës fillore, i gjendjes se dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 20.09.2019, rreth orës 20:00, pa autorizim ka poseduar me qëllim të shitjes, substanca narkotike, marihuan, ashtu që natën kritike, ne sheshin “...” në Mitrovicë, derisa Policia e ka ndaluar te pandehurin dhe gjatë kontrollës ne xhepin e xhaketës se tij kanë gjetur ... qese të paketuara, me substancë narkotike të llojit marihuana, një qese me substancë narkotike te llojit marihuana, gjithashtu kane gjetur edhe ... qese te zbrazëta te cilat shfrytëzohen për paketimin e substancave narkotike, e cila substancë përmban kanabisi (marihuana) e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC,) me peshë të përgjithshme prej ... gram, e cila edhe është sekuetsruar.

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 te KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 e 269 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Dënim me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Në dënimin e shqiptuar me burg i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 20.09.2019 deri më datë 20.11.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 20.11.2019 deri më datë 20.12.2019.
4. Në mbështetje të nenit 269 par.3 të KPRK-së, dhe nenin 282 par.2 nënpar. 2. 4 të KPPK-së, të pandehurit i konfiskohen sendet, dhe atë:
 - a. Substanca narkotike e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), me peshë ... gram;
 - b. Telefoni i llojit "...", ngjyrë ari dhe SIM kartela me IMEI: ... dhe IMEI 2:
 - c. Urdhërohet policia që të njëjta ta shkatërroj sipas procedurave në fuqi,
5. Obligohet i pandehuri, që t`i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve te Renda ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.235/2019, të datës 16.01.2020, ndaj të pandehurit L.B, për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datë 30.01.2023, ashtu që në këtë seancë i pandehuri L.B e ka pranuar në tersi fajësinë sipas aktakuzës, ka theksuar se ka qene i ri në moshë, pak më shumë se 18 vjeç, e di që atëherë kam gabuar dhe jam duke i vuajtur pasojat, ndihet i penduar thellësisht për këtë vepër, e lus gjykatën të merr parasysh rrethanat lehtësuese, tani jam i fejuar dhe shpresoj të marrohem e të krijoj familje, premtoj që nuk do të përsëri më vepra të tilla penale, jetoj vetëm me nënën që është e sëmure dhe ajo ka nevojë për kujdesin tim.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, ka deklaruar se, konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, prandaj i propozoj Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe këtë pranim ta marr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit në polici, datë 20.09.2019; Deklarata e të pandehurit dhënë në prokurori, datë 30.09.2019; Vërtetimin mbi marrjen e sendeve nga DKKO-DHTN- Mitrovicë me numër të rastit ... të datës 20.09.2019; Raporti i ekspertizës së AKF-së, nr. ..., datë 30.10.2019; Foto-dokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja se pas pranimit të fajësisë, nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari L.B ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

Gjykata me rastin e caktimit të dënimit, ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, dhe në kuptim të nenit 71 par. 1, nënpar. 1.3 të KPRK-së, kjo është rrethanë ligjore për zbutjen e dënimit. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes, sipas nenit 72 par. 1, nënpar. 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-së.

Si rrethanë rënduese gjykata në rastin konkret nuk gjenti ndonjë rrethanë. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit dhe premtimit se nuk do të përsëris më vepra të tilla, po ashtu faktin se i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së re.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit, ka urdhëruar marrjen e sendit, respektivisht substancës narkotike dhe telefonit mobil, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që janë rezultat i kryerjes së veprës penale dhe se janë përdorur për kryerjen e veprës penale, në mbështetje të nenit 115 par.2 nën par 2.1 dhe nenit 282 par.2 nën par 2.4 të KPP-së dhe nenit 267 par.5 të KPRK-së. Sa i përket telefonit, qartazi është send i përdorur për kryerjen e kësaj veprë penale ngasë komunikimi është bërë përmes tij.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450, par.2, pika 2.6, të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39, par.3, të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kohen e kaluar në masën e paraburgimit dhe masën e arrestit shtëpiak gjykata e llogariti në bazë të nenit 79 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463, të KPP-së, pasi që një kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar.

Andaj, gjykata, duke u bazuar me neni 365, 366 dhe 450 të KPPK-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Krimeve të Rënda
P.nr.01/2020, datë 30.01.2023
2019:208995, 30.01.2022

Kryetari i trupit gjykues

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.